

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.13.04.2023*

13.04.2023

Ora, 12:07

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për shqyrtimin administrativ ndaj personave përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
 2. Stafi KQZ: **Z. Y. Merkaj, Znj. M. Koja,
Z. E. Meta, Znj. V. Ballgjini**
- **Parti Politike:** **PDIU, BF, P.L, PLL, PD.**
- **TË TJERË:** **KRIIK, Bashkia Kamëz.**

Z. I. Celibashi: Mirë atëhere, fillojmë seancën publike e cila ka në rend dite miratimin e rezultatit të shortit për përcaktimin e renditjes të subjekteve zgjedhore në fletën e votimit, miratimin e rezultatit të shortit për përcaktimin e renditjes së kandidatit për kryetar bashkie në fletën e votimit për zgjedhjet e datës 14 maj 2023. Projektvendim për miratimin e sasisë së fletëve të votimit që do të prodhohen për çdo qendër votimi në zgjedhjet e datës 14. Kemi projektudhëzimin për përcaktimin e rregullave për mbledhjen, administrimin, publikimin, rezultatin paraprak të zgjedhjeve dhe miratimin e modeleve të dokumenteve që përdoren për nxjerrjen e rezultateve të zgjedhjeve për datën 14 maj. Shqyrtimin administrativ ndaj

*Zbardhi materialin audio
Jonida KOCAQI*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.13.04.2023*

personave përgjegjës për raportim të veprimtarive publike për zgjedhjet vendore të datës 14 maj. Kemi projektvendimin për dhënien e mandatit të deputetit disa kandidatëve të rradhës nga subjektet Partia Socialiste dhe Partia Demokratike Koalicioni Aleanca për Ndryshim për disa qarqe. Kemi projektvendimin për caktimin e partive politike që do të propozojnë anëtarin e tretë dhe të katërt të grupeve të numërimit të votave. Kemi projektvendimin për konstatimin e heqjes dorë nga kandidimi për kryetar Bashkie për zotin Mark Gjon Ruçi për Bashkinë e Mirditës nga Partia Demokratike. Nga seanca e djeshme kemi projektvendimin që lidhet me caktimin e kohës së transmetimit të fushatës elektorale të partive politike, subjekteve zgjedhore në radio televizionin publik. Mirë, atëherë edhe pse ndoshta është më me interes procedura që lidhen me hedhjen e shortit meqënëse ajo implikon kohë vazhdojmë me pikat e tjera të rendit të ditës. Po, përfaqësuesi i koalicionit “Bashkë Fitojmë”.

Z. A. Kaziaj: Faleminderit, zoti Celibashi. Të gjitha pikat e rendit të ditës, të ditës së sotme na janë njoftuar ditën e djeshme në orën 18:30 me përmbajtjen e tyre dhe me shqyrtimin e tyre ditën e sotme jemi dakord përveç pikës 10 të rendit të ditës e cila ka të bëjë me atë që ju sapo cituat do të donim pak më shumë kohë për të konsultuar dhe me ligjin dhe me përfaqësit tona të themi politike, faleminderit.

Z. I. Celibashi: Faleminderit, diskutime të tjera përfaqësuesit e partive të tjera politike? Nuk ka. Mirë dakord edhe për shkak të rëndësisë që ka ky akt edhe për faktin që nuk keni patur kohën e mjaftueshme në dispozicion për ta konsultuar, dakord do ta shty për një seanc tjetër projektvendimin që lidhet me caktimin e partive politike që do të propozojnë antarin e tretë dhe të katërt të grupeve të

*Zbardhi materialin audio
Jqida KOCAQI*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.13.04.2023*

numërimit të votave. Atëhere nëse jeni dakord për ta ndryshuar dhe radhën e shqyrtimit dhe procedurat e shortit t'i lëmë si pikë të fundit të rendit të ditë, mendoj që do të bënte sens. Dakord, mirë, unë do të propozoja të vazhdojmë me shqyrtimet e raporteve për veprimtarit e institucioneve dhe pastaj me zvëndësimin e kandidatëve, zvëndësimin e vakancave me kandidatet e radhës të listave shumemërore të kandidatëve për deputet. Po, Magdalena.

Znj. M. Koja: Komisioner, kemi administruar disa denoncime nga KRIK dhe jemi në fazën e shqyrtimit administrativ të tyre ndaj disa bashkive dhe konkretisht është një veprimtari e bashkisë Vlorë, veprimtari e raportuar në faqen e raportimeve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Ajo është një veprimtari e zhvilluar në datën 1 mars pretendohet që janë përdorur nxënësit e shkollës gjatë një takimi me votues për herë të parë ka qënë një përfaqësues deputet i cili ka postuar në rrjetin e tij *facebook* takimin me të rinjtë. Votues për herë të parë do të sjellin fitoren me 14 maj të Partisë Socialiste në Vlorë. Në kuadër të hetimit administrativ u është kërkuar informacion zyrës vendore të arsimit parauniversitar Vlorë, të cilët janë shprehur që nuk kanë asnjë informacion mbi këtë veprimtari të zhvilluar nga bashkia Vlorë në bashkëpunim me deputetin dhe pjesëmarrjen e të rinjve. Ndërkohë kemi thirrur sot në seancë të japi pretendimet e saj bashkia Vlorë e cila deri më tani megjithëse është kontaktuar edhe në rrugë zyrtare nuk ka shprehur asnjë pretendim në lidhje me veprimtari të raportuara nga ana e saj me pjesëmarrje të përfaqësuesve politik dhe bërjes thirrje në këtë veprimtari për të votuar Partinë Socialiste. Në djeninë tonë nuk ka përfaqësues të bashkisë Vlorë as në seancën e sotme. Ndërkohë është një veprimtari e paraportuar e bashkisë Lushnje është një takim i cili është zhvilluar në datën 21 mars. Në këtë veprimtari në fakt është takim

*Zbardhi materialin audio
Jonida KOCAQI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.13.04.2023*

i Drejtorisë Shërbimit Social të bashkisë me komunitetin rom dhe nuk kemi ende pretendime nga bashkia. Në dijeninë tonë as bashkia Lushnje nuk është paraqitur sot dhe ende nuk kanë dhënë pretendimet. Është një veprimtari e raportuar e bashkisë Librazhd, është raportuar si inspektim në ndërtimin e një shkolle. Nga çfarë shihet në video është inagurimi i një shkolle me pjesmarrje të drejtuesit politik. Nga sa kemi verifikuar nuk është bërë thirrje për të votuar në fakt gjatë ceremonisë megjithatë ne kemi kërkuar shpjegime dhe presim të na japin pretendimet e tyre.

Z. I. Celibashi: Aktiviteti i raportuar është i bashkisë?

Znj. M. Koja: Është i bashkisë.

Z. I. Celibashi: Po e kanë raportuar në ndërfaqe?

Znj. M. Koja: Po, gjatë inspektimeve nga sa verifikohet ai është një inagurim me pjesëmarrje të një deputeti nuk ka thirrje për të votuar , në një mënyrë të caktuar, në fakt nga sa kemi konstatuar ne. Është bashkia Kamëz për një veprimtari dhe ajo me përmbajtje të elementëve elektoral është një veprimtari me pjesëmarrje dhe ajo të personave politik por në rastin konkret postimi është në faqen e kryetarit të bashkisë dhe nuk rezulton e publikuar në faqen e bashkisë. Pra është një veprimtari me elemente elektoral e publikuar vetëm në faqen e kryetarit të bashkisë kamëz. Ende presim në fakt të na japin shpjegime të tyre bashkia kamëz por nuk na i ka dhënë deri në këtë moment në djenin tonë nuk është sot sot e pranishme për të dhënë shpjegime. Është!? Bashkia Kamëz? Kërkoj ndjesë atëhere. Po mund të na thoni.

*Zbardhi materialin audio
Jonida KOCAQI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.13.04.2023*

Z. I. Celibashi: Faleminderit përfaqësusit Levizja Legaliteti, emër mbiemër edhe funksioni që keni

Z. L. Deda: Përshëndetje, faleminderit kryetar. Unë jam Luan Deda përfaqësuesi me autorizim nga bashkia Kamëz në lidhje me ankesën që u tha. Atëhere në këtë rast është bërë një lapsus ose një gabim nga një punonjës i mediave i cili ka bërë një *share* në faqen e *facebook-ut*. Pra nuk është një publikim në faqen zyrtare të bashkisë Kamëz por duke mos pasur ndoshta dhe njohjen me kuadrin ligjor duke qënë dhe ditët e fillimit të ndalesave të këtyre publikimeve ka ndodhur ky lapsus. Baskia Kamëz deri më sot nuk është gjetur asnjëhere në shkelje në këto rrethana por në këtë rast është kjo që sapo thash.

Z. A. Kaziaj: Mundem zoti komisioner?

Z. I. Celibashi: Po.

Z. A. Kaziaj: Si palë me interes, për sa tha përfaqësuesi i bashkisë Kamëz mos njohja e ligjit nuk përbën që mos të kesh pasojat e ligjit pas. Kështuqë bërja e një *share-i* që konsideron zotëria është marrë nga diku nga dikush që e ka postuar atë dhe është promovuar dhe është bërë një, nga kërkesat që ligji ndalon kështuqë duhet ta marri parasysh KQZ-ja këtë gjë.

*Zbardhi materialin audio
Jonida KOCAQI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.13.04.2023*

Z. I. Celibashi: Na keni krijuar atë përshtypjen të një shqyrtimi në Danimark, dakord. Kishit diçka tjetër për të shtuar?

Z. L. Deda: Edhe njëherë po e sqaroj, nuk është një shpërndarje në faqen zyrtare dhe e bërë me vullnetin e kryetarit të bashkisë Kamëz pasi nuk ka ndodhur në rrethana të tjera por është një shpërndarje në *facebook*. Ndryshe nga ç'është në kërkesë dhe në ankesë pasi është në faqe zyrtare.

Z. I. Celibashi: Po aktiviteti që keni zhilluar aktiviteti i bashkisë ka qenë apo ka qenë aktivitet elektorale politik.

Z. L. Deda: Ka patur natyrë elektorale, duket sikur ka patur natyrë elektorale.

Z. A. Kaziaj: Atëherë përfitimi i drejtpërdrejtë ka qenë i kryetarit të bashkisë.

Z. I. Celibashi: Jo, vetëm me leje zoti Kaziaj vetëm me leje të lutem se nuk kishte mbaruar më duket.

Z. L. Deda: Jo, mbarova po, faleminderit!

Z. I. Celibashi: Po vazhdoni.

Z. A. Kaziaj: Nuk ndërhyj unë zoti Celibashi ju më njihni mirë, pres që të përfundojnë fjalën të tjerët.

*Zbardhi materialin audio
Jonida KOCAQI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.13.04.2023*

Z. I. Celibashi: Dakord, mirë në rregull. Gjë tjetër nuk kemi lidhur me këtë rast?

Znj. M. Koja: Jo, nuk kemi me këtë rast, kemi konstatuar me sa u pohua.

Z. I. Celibashi: Mirë, faleminderit!

Z. F. Topollaj: Nuk e kuptuam e ka hedhur tek faqja e tij ky person apo e ka hedhur ke faqja e bashkisë?

Znj. M. Koja: Vetëm te faqja e kryetarit të bashkisë, jo në faqen zyrtare të bashkisë as në rrjetin social të bashkisë. Vetëm te faqja personale.

Z. I. Celibashi: Vetëm personale. Kështu ishte apo jo?

Z. L. Deda: Po i nderuar kryetar është bërë në faqen e *facebook-ut* dhe jo në faqen zyrtare të bashkisë Kamëz.

Z. I. Celibashi: E kuptova, unë e kuptova.

Z. A. Kaziaj: Ke faqja personale e kryetarit të bashkisë dikush t'ja thotë që nuk është personale është gjithom në kuadër të pozicionit që ai ka, kur mos të ketë një pozicion publik pastaj ta bëjë personale.

Z. I. Celibashi: Dakord këtë do ta vlerësojmë, gjë tjetër për këtë rast nuk kemi, vazhdojmë.

*Zbardhi materialin audio
Jonida KOCAQI*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.13.04.2023*

Znj. M. Koja: Viojmë me bashkinë Poliçan. Është denoncuar një veprimtari e kryer nga bashkia Poliçan, e paraportuar në faqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Në fakt është takimi i drejtuesve politik të qarkut Berat, Ministrin të Brendshëm me strukturat e partisë socialiste e tjerë. Është bërë por në fakt nga sa ne kuptojmë ajo është një veprimtarin me përmbajtje elektorale me përmbajtje politike dhe nuk ka detyrim për tu raportuar në ndërfaqe. Ndërkohë bashkia Cërrik...

Z. I. Celibashi: Jeni duke thënë që ai aktivitetin politik e ka raportuar në ndërfaqe ndërkohë që nuk duhet ta raportonte.

Znj. M. Koja: Jo, është e paraportuar, sipas denoncuesve duhet ta kishin raportuar sepse ka pasur indicie për keqpërdorim të burimeve. Ndërkohë janë dy veprimtari të raportuara nga bashkia Cërrik, edhe denoncimi në rastin konkret është për zhvillim veprimtarish publike me përmbajtje elementësh elektorale është një inspektim në një kantier zbatimi të infrakstrukturës publike “Dasar”. Në fakt veprimtaria është planifikuar për tu zhvilluar në datën 10 mars dhe është raportuar brenda afatit ligjor në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Rezulton që në datën 6 mars kjo veprimtari duhet të jetë zhvilluar pra përpara datës së planifikuar dhe rezulton e publikuar në faqen *facebook* të drejtuesit politik të qarkut. E njëjta ngjarje është edhe për një rast të dytë. Për një veprimtari të raportuar nga bashkia Cërrik, inspektim në kantier dhe zbatim të infrastukturës publike dhe kjo e planifikuar për t’u zhvilluar në një datë tjetër dhe është zhvilluar përpara datës së raportuar, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Këtë indicie e marrim nga

*Zbardhi materialin audio
Jonida KOCAQI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.13.04.2023*

postimet në *facebook* dhe prandaj këtu është bazuar vetë denoncuesi. Çfarë ne i kemi kërkuar informacion në fakt bashkisë Cërrik ka të bëjë me fondet e vëna në dispozicion sepse janë inagurime për infrastrukturë publike, inspektim në kantiere, nuk kemi ende përgjigje nga ana e tyre. Këto janë rastet e hetimit që kemi sot të planifikuara.

Z. I. Celibashi: Dakord, nga ato që ka bërë KRIIK?

Znj. M. Koja: KRIIK i ka bërë këto që raportova, faleminderit.

Z. I. Celibashi: Mirë atëhere do të vendosim në një nga seancat e ardhshme në lidhje me këto raste. Ndërkohë edhe pse j'ua kemi njoftuar institucioneve përkatëse rastin nëse është e mundur ju bëjmë edhe një njoftim tjetër. Nëse do të kenë diçka për të shtuar sidomos rasti i Vlorës, përndryshe do të disponojmë me vendim. Nuk do të ketë seancë thjesht nëse kanë diçka tjetër me shkrim. Mirë atëhere vazhdojmë.

Z. A. Kaziaj: Diçka për procedurën vetëm. Për çka dëgjova nga drejtoresha, gjej rastin të falenderoj KRIIK dhe shumë organizata jo fitimprurës në Shqipëri, Qëndresën Qytetare dhe shumë të tjerë për shkak të denoncimeve që bëjnë në të mirë të zgjedhjeve të lira dhe të ndershme demokratike. Të gjitha tentativat që ata bëjnë për t'i sjellë pranë jush për t'i denoncuar aktivitetet e palejuara të cilat bëhen në pjesën më të madhe të tyre, nga të themi ajo që është makineria e vënë në dispozicion nga partia në pushtet. Do të doja që të merrni masa ju si Komisioner dhe gjithë administrata të themi e KQZ-së për të monitoruar këto aktivitete,


*Zbardhi materialin audio
Jonida KOCAQI*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.13.04.2023*

qofshin nëpërmjet detyrave që i ka lënë ligjvënsi në veçanti. Në mënyrë që t'i garantojmë qytetarëve zgjedhje të lira të ndershme të pa ndikuara. Ndërkohë që në përditshmëri si qytetarë shohim një ndikim të jashtëzakonshëm të vënë në mekanizëm nga kjo makineria e madhe shtetërore e cila ka filluar me shtrimin e rrugve. Po ta shihni në çdo cep të qytetit të Tiranës dhe në të gjitha qytetet e Shqipërisë dhe me shumë aktivitete të tjera të cilat jo paqëllim janë lënë në këtë moment për të krijuar idenë tek qytetarët Shqipëtar që po bëjmë diçka për ju dhe për të orientuar votën me pa meritë, në një subjekt i cili po sillet në mënyrë të hapur në kundërshtim me ligjin. Kështu që do të doja të sillja në vëmendje këtë gjë publikisht duke falenderuar siç e thashë në fjalën time dhe KRIIK dhe Qëndresës Qytetare dhe të gjithë qytetarëve që denoncojnë. Subjekte, qofshin këto apo qytetarë privatë që denoncojnë pranë ndërfaqes në mënyrë që të shqyrtohet me objektivitet nga ana juaj çdo denoncim dhe t'i jepet përgjigjja e duhur personit shkelës së ligjit, faleminderit.

Z. I. Celibashi: Faleminderit zoti Kaziaj, bashkohem edhe unë me vlerësimet tuaja për organizatat e shoqërisë civile. Inkurajojmë që ato të përcjellin në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve çdo fakt në vlerësim të tyre konsiderohet si shkelje e dispozitave të Kodit Zgjedhor veçanërisht për sa i përket përdorimit të fondeve dhe asetëve publike. Ky inkurajim vlen për këdo qytetar, po vlen padyshim dhe për partitë politike dhe pse ato janë të interesuara dhe kanë interesin themelor për të denoncuar rastet e abuzimit me fondet publike apo dhe me asetet publike, dakord.

*Zbardhi materialin audio
Jonida KOCAQI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt13.04.2023*

13.04.2023
Ora 12:25

RENDI I DITËS

*Projektvendim “Për dhënien e mandatit të Deputetit të Kuvendit të Shqipërisë,
kandidatit të rradhës së listës shumëpartiake të Partisë Socialiste të Shqipërisë”,
qarku Elbasan, z. Shkëlqim Shefqet Bullari.*

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
 2. Stafi KQZ: **Z. Y. Merkaj, M. Koja, V. Ballgjini**
- **Parti Politike:** **PDIU, BF, PL, PLL, PD**
- **Të tjerë:** **KRIIK**

Z. I. Celibashi: Atëhere kalojmë tek pikat e rendit të ditës që kanë të bëjnë me zvendësimin e vakancave në Kuvendin e Shqipërisë.

Z. Y. Merkaj: Kuvendi i Shqipërisë ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës në Kuvend. Vakancë e krijuar si pasojë e tërheqjes së mandatit të deputetit, zotit Visjon Gëzim Ajazi zgjedhur në zonën zgjedhore të qarkut Elbasan propozuar nga Partia Socialiste. Në zgjedhjet për Kuvend të datës 25.04.2021 Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendimin numër 416 datë 23.06.2021 ka miratuar shpërndarjen e mandateve midis subjekteve zgjedhore për caktimin e mandateve fitues që dhe renditjen e kandidatëve të cilët nuk kanë fituar

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt13.04.2023*

mandate në bazë të numrit të votave parapëlqyese në zonën zgjedhore qarku Elbasan në zgjedhjet e datës 25 prill 2021. Sipas këtij vendimi Partia Socialiste në zonën zgjedhore qarku Elbasan ka fituar 8 mandate. Po sipas këtij vendimi rezulton se kandidati të cilit i kalon mandati i deputetit është kandidati me numër rendor 9. zoti Shkëlqim Shefqet Bullari. I cili ka plotësuar dhe depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve formularin e deklarimit me numër unik-16. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile dhe zyra e gjendjes gjyqësore. Ku në përgjigje të kërkesës sonë “Drejtoria e Gjendjes Civile” ende nuk ka kthyer përgjigje ndërsa “Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore” ka sjellë verifikimin e gjendjes gjyqësore të kandidatit për deputet për zonën zgjedhore të qarkut Elbasan, ku përcaktohet se kandidati nuk është i dënuar me vendim penal të formës së prerë. Pas verifikimeve të kryera, referuar dhe pikës 2, të kreut 5, të vendimit nr. 17, të vitit 2016, të Kuvendit, konstatohet se zoti Shkëlqim Shefqet Bullari, nuk përbën kusht për moszgjedhjen e kandidatit në funksion të Deputetit të Kuvendit të Shqipërisë. Përsa më sipër, mandati i ndërprerë i deputetit Besjon Gëzim Ajazi, i përket kandidatit vijues në listën shumemërore të Partisë Socialiste, për zonën zgjedhore qarku Elbasan, i renditur me nr. Rendor 9, zoti Shkëlqim Shefqet Bullari. Faleminderit!

Z. I. Celibashi: Mirë, faleminderit! Atëhere, meqënëse nuk ka asnjë ndalim për të marrë mandatin nga kandidati i rradhës, vendos dhënien e mandatit të Deputetit të Republikës së Shqipërisë, kandidatit të rradhës në listën shumemërore të Partisë Socialiste të Shqipërisë, për zonën zgjedhore qarku Elbasan, zotit Shkëlqim Shefqet Bullari. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankimi në Komisionin e Ankimimit dhe Sanksioneve brenda tre ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi dhe ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së. **Vendimi nr. 347**

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt13.04.2023*

**13.04.2023
Ora 12:28**

RENDI I DITËS

*Projektvendim “Për dhënien e mandatit të Deputetit të Kuvendit të Shqipërisë,
kandidatit të rradhës së listës shumëmemërore të Koalicionit “Partia Demokratike-
Aleanca për Ndryshim”, qarku Tiranë, z. Asllan Shaban Dogjani.*

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
 2. Staf i KQZ: **Z. Y. Merkaj, M. Koja, V. Ballgjini**
- **Parti Politike:** **PDIU, BF, PL, PLL, PD**
- **Të tjerë:** **KRIIK**

Z. I. Celibashi: Po, vazhdojmë.

Z. Y. Merkaj: Kuvendi i Shqipërisë ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës në Kuvend për shkak të tërheqjes nga mandate të deputetit, të zotit Belind Zamir Këlliçi, i zgjedhur në zonën zgjedhore qarku Tiranë, propozuar nga Koalicioni Partia Demokratike-Aleanca Për Ndryshim. Pas shpalljes së rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve, Komisioneri Qendror i Zgjedhjeve, me vendimin nr.409, datë 23.06.2021, ka miratuar shpërndarjen e mandateve midis subjekteve zgjedhore, përcaktimi i kandidatit fitues si edhe renditjen e kandidatëve të cilët nuk kanë fituar mandat në bazë të numrit të votave parapëlqyese, në zonën zgjedhore të qarkut Tiranë, për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021. Sipas këtij vendimi,

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt13.04.2023*

Koalicioni Partia Demokratike-Aleanca për Ndryshim, në zonën zgjedhore qarku Tiranë, ka fituar 15 mandate, po sipas këtij vendimi, kandidatit të cilit i kalon mandate i këtij deputeti është kandidati me numër rendor 18, zoti Asllan Shaban Dogjani, i cili i përket Koalicionit Partia Demokratike-Aleanca për Ndryshim. Kandidati për deputet ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve formularin e vetdeklarimit me numër unik 14, ku nga verifikimi i formularit të vetdeklarimit konstatohet se nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me ndalimet në ligjin numër 138, të vitit 2015. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka kërkuar informacion nga zyra e Gjendjes Civile dhe zyra e Gjendjes Gjyqësore, ku në përgjigje të kërkesës sonë, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes civile, ende nuk ka kthyer përgjigje, ndërsa Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore ka dërguar verifikimin gjyqësor, të gjendjes gjyqësore të kandidatit, ku përcaktohet se nuk është i dënuar me vendim penal të formës së prerë. Pas verifikimeve të kryera referuar pikës 2, të kreut 5, të vendimit 17, të vitit 2016 të Kodit, konstatohet se kandidati për deputet, zoti Asllan Dogjani nuk përbën kusht për moszgjedhjen e tij në funksionin e deputetit. Përsa më sipër projektvendimi për shqyrtim dhe miratim. Faleminderit!

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Atëhere meqënëse nuk ka asnjë ndalim për shkak të ligjit, vendosim dhënien e mandatit të Deputetit të Kuvendit të Reublikës së Shqipërisë, kandidatit të rradhës në listën shumemërore të Koalicionit Partia Demokratike-Aleanca Për Ndryshim, për zonën zgjedhore qarku Tiranë, zotit Asllan Shaban Dogjani. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankimi në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve brënda tre ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi dhe ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Vendimi nr. 348

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt13.04.2023*

13.04.2023
Ora 12:30

RENDI I DITËS

*Projektvendim “Për dhënien e mandatit të Deputetit të Kuvendit të Shqipërisë,
kandidatit të rradhës së listës shumëmemërore të Koalicionit “Partia Demokratike-
Aleanca për Ndryshim”, qarku Shkodër, z. Lodovik Stak Hasani.*

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
 2. Staf i KQZ: **Z. Y. Merkaj, M. Koja, V. Ballgjini**
- **Parti Politike:** **PDIU, BF, PL, PLL, PD**
- **Të tjerë:** **KRIIK**

Z. Y. Merkaj: Kuvendi i Shqipërisë ka njoftuar Komisionin Qendror të zgjedhjeve për krijimin e vakancës në Kuvend për shkak të dorëheqjes nga mandati i deputetit, zotit Zef Kil Hila, propozuar nga Partia Demokratike, zgjedhur në zonën zgjedhore qarku Shkodër propozuar nga Koalicioni Partia Demokratike-Aleanca Për Ndryshim. Pas shpalljes së rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve për Kuvend të datës 25 prill 2021, Komisioneri me vendin nr. 410, datë 23.6.2021 ka miratuar shpërndarjen e mandateve midis subjekteve zgjedhore, përcaktimin e mandateve fituese, si dhe rirënditjen e kandidatëve të cilët nuk kanë fituar mandat në bazë të numrit të votave parapëlqyese. Sipas këtij vendimi Koalicioni Partia Demokratike-Aleanca Për Ndryshim, për zonën zgjedhore qarku Shkodër ka fituar 5 mandate. Po

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt13.04.2023*

sipas këtij vendimi rezulton se kandidati të cilit i kalon mandati i deputetit është kandidati me numër rendor 7, zoti Lodovik Stak Hasani, i cili ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve formularin e vetëdeklarimit me numër unik 17. Nga verifikimi i formularit konstatohet se nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me ndalimet në ligj numër 138 të vitit 2015. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka kërkuar informacion nga zyra e Gjendjes Civile dhe zyra e Gjendjes Gjyqësore, ku në përgjigje të kërkesës sonë, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes civile, ende nuk ka kthyer përgjigje, ndërsa Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore ka dërguar verifikimin e gjëndjes gjyqësor të kandidatit, ku konstatohet se nuk është i dënuar me vendim penal të formës së prerë. Në këto kushte, pas verifikimeve të kryera dhe referuar pikës 2, të kreut 5, të vendimit 17, të Kuvendit, konstatohet se kandidati Ludovik Stark Hasani nuk përbën kusht për moszgjedhjen e kandidatit në funksionin e deputetit. Bashkëlidhur kemi projektvendimi për shqyrtim dhe miratim.

Z. I. Celibashi: Atëhere dhe në këtë rast meqënëse nuk ka asnjë ndalim nga ligji, vendos dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, kandidatit të rradhës në listën shumëmemërore, të Koalicionit Partia Demokratike-Aleanca Për Ndryshim, nga Partia Republikane, qarku Shkodër, zotit Ludovik Stark Hasani. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankimi në KAS brënda tre ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi dhe ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Vendimi nr. 349

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt 13.04.2023*

13.04.2023
Ora 12:32

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për dhënien e mandatit të Deputetit të Kuvendit të Shqipërisë, kandidatit të rradhës së listës shumëmemërore të Koalicionit “Partia Demokratike-Aleanca për Ndryshim”, qarku Elbasan, z. Qani Rexhep Xhafa.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
 2. Stafi KQZ: **Z. Y. Merkaj, M. Koja, V. Ballgjini**
- **Parti Politike:** **PDIU, BF, PL, PLL, PD**
- **Të tjerë:** **KRIIK**

Z. Y. Merkaj: Kuvendi i Shqipërisë ka njoftuar Komisionin Qendror të zgjedhjeve për krijimin e vakancës në Kuvend për shkak të dorëheqjes nga mandati i deputetit, zotit Luçiano Dhimitër Boçi, i zgjedhur në zonën zgjedhore qarku Elbasan, propozuar nga Koalicioni Partia Demokratike-Aleanca Për Ndryshim. Pas shpalljes së rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve të datës 25 prill 2021, Komisioneri ka miratuar shpërndarjen e mandateve midis zonave të subjekteve zgjedhore, përcaktimin e mandateve fituese, si dhe rirenditjen e kandidatëve të cilët nuk kanë fituar mandate në bazë të numrit të votave parapëlqyese, në zonën zgjedhore, qarku Elbasan. Sipas këtij vendimi Koalicioni Partia Demokratike-Aleanca Për Ndryshim,

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt13.04.2023*

në zonën zgjedhore qarku Elbasan, ka fituar 6 mandate, po sipas këtij vendimi rezulton se kandidati të cilit i kalon mandati i deputetit, është kandidati me numër rendor 7, zotit Qami Rexhep Xhafa i cili ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve formularin e vetëdeklarimit me numër unik 15. Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit konstatohet se nuk ka përbën kusht për moszgjedhjen e kandidatit në funksion të deputetit. Gjithashtu Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka kërkuar informacion nga zyra e Gjendjes Civile dhe zyra e Gjendjes Gjyqësore, ku Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes civile, ende nuk ka kthyer përgjigje ndërsa Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore ka dërguar verifikimin e gjëndjes gjyqësor të kandidatit për deputet, ku konstatohet se nuk është i dënuar me vendim penal të formës së prerë. Në këto kushte, pas verifikimeve të kryera dhe referuar referuar pikës 2, të kreut 5, të vendimit numër 17, të vitit 2016, të Kuvendit të Shqipërisë, konstatohet se të dhënat e kandidatit për deputet, të zonës zgjedhore qarku Elbasan, zoti Qami Rexhep Xhafa, nuk përbën kusht për moszgjedhjen e tij në funksionin e deputetit. Bashkëlidhur kemi projektvendimi për shqyrtim dhe miratim. Faleminderit!

Z. I. Celibashi: Mirë, faleminderit! Atëhere meqënëse dhe për këtë kandidat të rradhës nuk ka ndalime të ligjit, vendos dhënien e mandatit të Deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, për kandidatin e rradhës në listën shumëmemërore, të Koalicionit Partia Demokratike-Aleanca Për Ndryshim, për zonën zgjedhore qarku Elbasan, zotit Qami Rexhep Xhafa. Si për këtë rast dhe për rastin e zotit Dugjani, sipas përkatësisë të partive politike, në listë do duhet të bëhet, meqënëse e kemi ndjekur edhe në rastet e tjera. Nuk mbaruam me rendin e ditës, po them që duhet të bëjmë saktësimin në lidhje me përkatësinë e partisë, se e kemi bërë vetëm në një rast, nuk e kemi bërë në rastet e tjera. Të kujt partie janë? Sepse në listën

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Di13.04.2023*

shumemërore të Koalicionit, në krahë të kandidatit është edhe partia të cilës i përket, dhe kur kemi shpallur rezultatin e zgjedhjeve kemi evidentuar edhe se cilës parti.

Z. Y. Merkaj: Për Asllan Dogjanin e kemi bërë, edhe për Ludovikun, do ta bëjmë edhe për Qamilin.

Z. I. Celibashi: Po pra për një, mungon për një. Dakord, mirë.

Vendimi nr. 350

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Di13.04.2023*

13.04.2023
Ora 12:36

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për përcaktimin e rregullave për mbledhjen, administrimin, publikimin e rezultatit paraprak të zgjedhjeve dhe miratimin e modeleve të dokumentave që përdoren për nxjerrjen e rezultateve të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
 2. Staf i KQZ: **Z. Y. Merkaj, M. Koja, V. Ballgjini**


- **Parti Politike:** **PDIU, BF, PL, PLL, PD**

- **Të tjerë:** **KRIIK**

Z. I. Celibashi: Atëhere vazhdojmë me pikën e rendit të dites që ka të bëjë me miratimin, me udhëzuesin për rregullat për mbledhjen, administrimin, publikimin e rezultatit paraprak të zgjedhjeve, si dhe miratimin e modeleve.

Z. Y. Merkaj: Neni 119 i Kodit Zgjedhor parashikon se tabela origjinale e rezultateve të votimit i dorëzohet përnjëherë dorazi KZAZ-së nga grupi i numërimit. Kjo kopje e tabelës së rezultateve i jepet çdo anëtar i grupit të numërimit dhe vëzhguesëve të subjekteve zgjedhore. Një kopje dërgohet menjëherë në rrugë elektronike në KQZ,

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt13.04.2023*

dhe KQZ-ja publikon në faqen e internetit numrin e rezultateve zyrtare për çdo Qendër Votimi sapo i merr ato zyrtarisht nga KZAZ-ja. Publikimi duhet të saktësojë se rezultati është paraparak. Referuar dhe nenit 120 dhe 122 të Kodit Zgjedhor është përgatitur projektudhëzimi për përcaktimin e rregullave për mbledhjen, administrimin, publikimin e rezultatit paraparak të zgjedhjeve dhe miratimin e modeleve të dokumentacionit që përdorim për të nxjerrë rezultatin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore. Ky udhëzim ka për qëllim të përcaktojë rregullat që do të zbatohen në mbledhjen, administrimin dhe publikimin e rezultatit paraparak të zgjedhjeve, si dhe të miratojë modelet e dokumentacionit që përdoret për të nxjerrë rezultatet për organet e qeverisjes vendore. Ky udhëzim parashikohet të dërgohet në rrugë elektronike nga KZAZ-ja në KQZ, gjithashtu dhe përmbajtja e informacionit për rezultatin e zgjedhjeve. Kushtet që duhet të plotësojë aplikacioni kompjuterik për hedhjen, transmetimin dhe publikimin e rezultatit paraparak gjithashtu është parashikuar dhe përgjegjësia që përcjell informacioni në KQZ, e cila është përgjegjësi e Sekretarit të KZAZ-së. Në projektudhëzim është parashikuar dhe mënyra e hedhjes së informacionit të rezultateve nga KZAZ-ja në KQZ, dhe publikimi i informacionit për rezultatet paraprake, i cili parashikon se me marrjen e informacionit nga KZAZ-ja, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve bën publikimin në dinamikë të rezultatit paraparak në rang bashkie dhe QV-je. Publikimi i informacionit të mësipërm bëhet në faqen e KQZ-së në internet, ndërsa në monitor të sallës së mediave publikimi bëhet vetëm në rang bashkie. Në udhëzimet e parashikuara prodhimi dhe administrimi i modeleve të dokumentacionit për rezultat si dhe dispozitat e fundit të hyrjes në fuqi. Bashkëlidhur keni projektudhëzimin e mësipërm si dhe tabelat e rezultateve për çdo Qendër Votimi, KZAZ. Faleminderit!

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt13.04.2023*

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Përfaqësues të partive politike, besoj dakord me projektaktin. Pak a shumë janë të njëjta modele të përdorura në vitin 2021, dhe e njëjta procedurë për pasqyrimin e rezultateve paraprake nga grupet e numërimit nga KZAZ-ja dhe përcjelljen e tyre në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Mirë atëhere, meqënëse dhe nga përfaqësuesit e partive politike janë dakord me përmbajtjen, e miratojmë atë sipas draftit të propozuar.

Udhëzimi nr. 2

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.13.04.2023*

**13.04.2023
Ora 12:39**

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për miratimin e sasisë së fletëve të votimit që do të prodhohen për çdo qendër votimi për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
 2. Stafi KQZ: **Z. Y. Merkaj, M. Koja, V. Ballgjini**
- **Parti Politike:** **PDIU, BF, PL, PLL, PD**
- **Të tjerë:** **KRIIK**

Z. I. Celibashi: Kalojmë te projektvendimi që lidhet me sasinë e fletëve të votimit që do të prodhojmë për çdo Qendër Votimi.

Z. Y. Merkaj: Neni 97, pika 4 e Kodit Zgjedhor parashikon se sasia e fletëve të votimit është e barabartë me numrin e zgjedhësve duke shtuar 2%. Gjithashtu referuar nenit 10, të udhëzimit nr. 1, të vitit 2020, të Komisionit Rregullator, është përcaktuar dhe afati, dhe mënyra e dërgimit të të dhënave për numrin përkatës të zgjedhësve në listën zgjedhore dhe për çdo Qendër Votimi. Drejtoria e Përgjithshme e gjendjes Civile ka dërguar listën përfundimtare të zgjedhësve, dhe nga përpunimi

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.13.04.2023*

i të dhënave rezulton se në rang vëndi janë gjithësej 5211 Qendra Votimi, dhe numri i zgjedhësve është 3650550 zgjedhës në rang vëndi. Me vendimin numër 22 dhe vendimin numër 23, të Komisionerit në Bashkinë Elbasan, Kamëz dhe Vorë do të zbatohet projekti pilot për votimin dhe numërimin elektronik, dhe për këto bashki nuk duhet të prodhohet sasia e plotë e fletëve të votimit. Sasia e fletëve të votimit që do të prodhohet për bashkitë ku implementohet votimi dhe numërimi elektronik do të përcaktohet me një akt të veçantë të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Sasia e fletëve të votimit që do të prodhohet për 4810 Qendra Votimi është 3389407 zgjedhës. Referuar pikës 4, neni 37 të Kodit Zgjedhor sasia e fletëve të votimit që duhet të prodhohet për zgjedhjet për organet të qeverisjes vendore datës 14 maj 2023, duke i shtuar dhe 2% të numrit të zgjedhësve është 3404156 fletë votimi. Bashkëlidhur kemi projektvendimin për shqyrtim dhe miratim. Faleminderit!

Z. I. Celibashi: Atëhere dhe një herë, përjashtuar Bashkinë Elbasanit, Kamzës dhe të Vorës, sasia e fletëve të votimit për bashkitë e tjera do të jetë sipas parashikimeve të ligjit, numri i zgjedhësve plus 2%. Për këto tre bashki mund të bëjmë një konsultë me përfaqësues të partive politike në lidhje me atë që do t'i prodhojmë fletët e votimit për këto tre bashki apo jo. Dakord? Nëse kërkoni kohë për ta konsultuar...

Z. A. Kaziaj, përfaqësuesi i PL: Mirë do ishte në çdo rast, për pasjen e një plani të dytë, kështu që mirë do ishte.

Z. I. Celibashi: Ju jeni që t'i prodhojmë edhe për ato.

Z. A. Kaziaj, përfaqësuesi i PL: Të konsultohemi njëherë, përpara se të kemi një qëndrim.

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.13.04.2023*

Z. I. Celibashi: Ndaj po them, kështu që gjithsesi në një moment të dytë vendosim se çfarë do të bëjmë me këtë çështje, pra do t'i prodhojmë ose jo fletët e votimit për këto tre bashki ku do të zhvillohet votimi elektronik. Mirë dalord, atëhere për pjesën tjetër të bashkive, sipas draftit të propozuar sasia e fletëve të votimit për çdo Qendër Votimi dhe për çdo bashki.

Vendimi nr. 351

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt13.04.2023*

13.04.2023
Ora 12:42

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për konstatimin e heqjes dorë nga kandidimi për kryetar bashkie të z. Mark Gjon Ruci, kandidat i propozuar nga Partia Demokratike për Bashkinë Malsia e Madhe, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
 2. Staf i KQZ: **Z. Y. Merkaj, M. Koja, V. Ballgjini**
- **Parti Politike:** **PDIU, BF, PL, PLL, PD**
- **Të tjerë:** **KRIIK**

Z. I. Celibashi: Kalojmë te pika tjetër që ka të bëjë me konstatimin e heqjes dorë nga kandidimi si Kryetar Bashkie të zotit Mark Gjon Ruçi, kandidat i propozuar nga Partia Demokratike, për Bashkinë e Mirditës.

Z. Y. Merkaj: Subjekti zgjedhor, Partia Demokratike brënda afatit ligjor ka depozituar gjithë dokumentacionin për regjistrimin e kandidatit për Kryetar Bashkie, të Bashkisë Mirditë, dhe në zbatim të nenit 67, pika 1, dhe neni 73 të Kodit Zgjedhor KZAZ-ja numër 14, Bashkia Mirditë, me vendimin numër 8, datë 28.03.2023, ka vendosur regjistrimin e kandidatit, zotit Mark Gjon Ruçi, si kandidat

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt13.04.2023*

i propozuar nga subjekti zgjedhor Partia Demokratike. Me datën 12.04.2023 kandidati për Kryetar Bashkie, të Bashkisë Mirditë zotit Mark Gjon Ruçi ka depozituar në KZAZ numër 14, Bashkia Mirditë, kërkesën për dorëheqje nga kandidimi. Në këto kushte ngelet në vlerësimin tuaj.

Z. I. Celibashi: Mirë, dakord. Veç konstatimit të këtij fakti, nuk kemi se çfarë vendimi të marrim, kështu që nuk do të jetë emri i tij në fletën e votimit, për kandidatët për Kryetar Bashkie, për Bashkinë e Mirditës.

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.13.04.2023*

13.04.2023
Ora 12:42

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për caktimin e kohës së transmetimit në radiotelevizionin publik të fushatës zgjedhore të partive politike të regjistruara si subjekte zgjedhore, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
 2. Stafi KQZ: **Z. Y. Merkaj, M. Koja, V. Ballgjini**
- **Parti Politike:** **PDIU, BF, PL, PLL, PD, LB**
- **Të tjerë:** **KRIIK**

Z. I. Celibashi: Kalojmë te pika tjetër e rendit të ditës, që ka të bëjë me caktimin e minutazhit...

Z. Y. Merkaj: Atëhere neni 11, paragrafi 1, shkronja e, e Kodit Zgjedhor, parashikon kompetencat e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, për monitorimin nëpërmjet administratës së KQZ-së, apo subjekteve të kontraktuara të fushatës zgjedhore, të gjithë aspektet e financimit të fushatës zgjedhore, si dhe pasqyrimin e fushatës në media. Neni 80, pika 1, e Kodit Zgjedhor, përcakton se radiotelevizioni publik vë minutazh falas në dispozicion të partive politike të regjistruara në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si subjekte zgjedhore, për të bërë fushatën për zgjedhjet e datës 14 maj 2023. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 80, shkronja b dhe c, të Kodit Zgjedhor, përcakton minutazhin për partitë parlamentare siaps

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.13.04.2023*

numrit të vëndeve në Kuvend, dhe që ato kanë marrë në zgjedhjet e fundit, si dhe për partitë joparlamentare. Projektvendimi paraqet partitë parlamentare të cilat në zgjedhjet e fundit për Kuvend kanë marr më shumë se 20% të vëndeve në Kuvend, KQZ-ja cakton një minutazh të barabartë me jo më pak se 30 minuta falas në televizionin publik, dhe po aq në radio publike. Për partitë e tjera parlamentare kjo kohë është jo më pak se 15 minuta. Çdo parti joparlamentare që merr pjesë në zgjedhje fiton 10 minuta falas në televizionin publik, dhe 10 minuta falas në radio publike. Me vendimin 21, datë 13.07.2021, të Komisionit Rregullator, është shpallur rezultati përfundimtar i zgjedhjeve, duke përcaktuar dhe numrin e mandateve të fituara në Kuvend nga çdo subjekt zgjedhor. Bazuar në numrin e mandateve të fituara në zgjedhjet e fundit për Kuvend rezulton se partitë parlamentare të cilat në zgjedhjet e fundit kanë marrë më shumë se 20% të vendeve në Kuvend, dhe që janë regjistruar si subjekte zgjedhore për zgjedhjet e datës 14 maj 2023, janë Parita Socialiste dhe Partia Demokratike, partitë e tjera parlamentare që në zgjedhjet e fundit për Kuvend kanë marrë me pak se 20% të votave dhe janë regjistruar si subjekte zgjedhore për këto zgjedhje janë Partia Social-Demokrate, Partia e Lirisë, Partia Republikane Shqipëtare, Partia Drejtësi Integrim dhe Unitet, Partia Agrare Ambjentaliste, Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut, Lëvizja për Zhvullim Kombëtar dhe Partia Levizja e Legalitetit. Duke analizuar nenin 80, shkronja b, minutazhi falas iu vihet në dispozicion partive politike të regjistruara apo koalicionit, bazuar në parimin e proporcionalitetit. Si subjekte zgjedhore pjesëmarrëse në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, datë 14 maj 2023, janë regjistruar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve edhe parti politike joparlamentare, që konkurojnë më vete apo si parti pjesëtare të koalicionit të cilat në zbatim të nenit 80, pika 1, përfitojnë 10 minuta falas në televizion publik, dhe 10 minuta falas në radio publike. Në përfundim të sa më sipër i propozohet Komisionerit si vijon, caktimi i

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve,
Dt.13.04.2023*

minutazhit kohor, trasmetimit të barabartë prej 40 minutash në televizionin publik dhe 20 minuta në radio publike, për pasqyrimin e fushatës zgjedhore, të subjekteve zgjedhore si më poshtë: Partia Socialiste dhe Partia Demokratike. Caktimi i minutazhit të transmetimit i barabartë prej 25 minutash në televizionin publik dhe 15 minuta në radio publike për pasqyrimin e fushatës për partitë parlamentare si më poshtë: Partia e Lirisë, Partia Social-Demokrate, Partia Republikane, Partia Drejtësi Integrim dhe Unitet, Partia Agrare Ambjentaliste, Lëvizja për Zhvillim Kombëtar, Partia Lëvizja e Legalitetit dhe Partia Bahkimit për të Drejtat e Njeriut. Caktimi i minutazhit kohor për transmetimin falas e barabartë prej 10 minutash në televizionin publik dhe 10 minuta në radio publike, për pasqyrimin e fushatës sipas lidhjes 1, për partitë joparlamentare, gjithashtu caktimi i një minutazhi kohor transmetimi i barabartë me 5 minuta në televizionin publik dhe 5 minuta në radio publike, për pasqyrimin e fushatës për secilin kandidat për Kryetar Bashkie apo anëtar të këshillit bashkiak të propozuar nga zgjedhësit. Bashkëlidhur kemi vendimin për shqyrtim dhe miratim, si dhe lidhjen numër 1, për partitë joparlamentare. Faleminderit!

Z. I. Celibashi: Përfaqësues të partive politike në lidhje me këtë? Po!

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i PL: Një kërkesë për sqarim! Propozimi në pikën 2 i referohet një minutazhi prej 25 minutash për të gjitha partitë politike që kanë marrë 20%. Flasin për 25 minuta për çdo subjekt politik të regjistruar apo është kohë totale për të gjithë subjektet bashkarisht?

Z. I. Celibashi: Po, po për secilin subjekt është 25 minuta. Kam dhe unë një pyetje. Kemi vendosur 25 minuta dhe 40 minuta, edhe pse për kohën e transmetimit (kohën që vihet në dispozicion) nuk ka ndonjë rregull strikt të përcaktuar veç faktit se sa do

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.13.04.2023*

të jetë minimumi, mungon ky raporti i dyfishit që për analogji i jepet partive politike. Dyfishi i kohës ndërmjet partive që kanë marrë 20% dhe ato që kanë 20 % , domethënë 40 me 25. Ose ta bëjnë 40 me 20 ose 50 me 25 minuta. Por Partia e Lirisë nuk do të pranonte që t'i uleshin minutat kam përshtypjen. Për princip! Nëse ata... do të preferoja dhe ne fakt nuk është çështje preferimi por për shkak të numrit të madh të subjekteve mos të okupohej e gjithë koha televizive në televizionin publik edhe pse interesi i partive politike është që të ketë sa më shumë minuta por...

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i PL: Ne jemi parti opozitare zoti Celibashi kështuqë, pavarësisht se ligji përcakton rregulla të qarta do të duhet që armët të jenë të barabarta të paktën. Fakti është që dhënia e minutave a imponohet nëpërmjet një kohe të caktuar kur duhet të jepen ato nga ana e televizionit publik dhe jo publike apo e përzgjedh vetë institucioni, domethënë televizioni në këtë rast se kur mund ta shfaqim një reklamë lidhur me një parti të caktuar ose 1 koalicion të caktuar?

Z. I. Celibashi: Ajo është kohë që vihet në dispozicion për të bërë një fushatë elektorale nëpërmjet televizionit publik, nuk ka të bëjë me reklamat politike. Do të prezantoni programin politik, ky është rasti. Sepse ligji parashikon që vetëm televizioni publik vë kohë në dispozicion. Në rastet e televizioneve private jeni të detyruar që të paguani për reklamat politike dhe nuk keni të drejtë për të patur kohë në dispozicion. Por gjithë diskutimi është për ti rregulluar këto raportet dhe ftesa ime ishte nga 25 minuta ti bëjmë 20 minuta, nuk është ndonjë diferencë por gjithsesi... Ju i doni ato minuta?!

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i PL: Janë të domosdoshme!

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.13.04.2023*

Z. I. Celibashi: Jo që mos ti shtojmë edhe partive të tjera, nga 40 ti bëjmë 50... Mirë e lejmë kështu, 40 minuta në televizionin publik. Partia Socialiste dhe Partia Demoratike, janë 2 parti në fakt që përfitojnë 40 minuta dhe meqënëse...

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i PL: Koalicioni do të mari 50 minuta, koalicioni që kanë këto parti nëqoftëse shkojnë nga 25 minuta në përfundim do të kenë 75 minuta kohë.

Z. I. Celibashi: Jo! Kërkesa është e përligjur në çdo rast edhe juaja edhe e përfaqësuesit të Lirisë.

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i PL: Dakord! Jo jo për të arritur tek çështja e minutave që i duhen koalicionit që është e kuptueshme se të gjithë opozitë jemi dhe kërkojmë kohë më shumë. Por në fund të ditës koalicioni merr kohë pothuajse sa dyfishi i partive kryesore opozitare. Në terma praktik deri sa jemi në këtë kuadër ligjor të pandryshuar, teknikisht kjo ndodh.

Z. I. Celibashi: Nëse do të ishit më shumë parti në koalicion do t'i përfitonin ato minuta, e kuptoj. Po mirë atëhere për të mos cënuar edhe interesin e partive të vogla të themi që kanë nën 20% të mandateve (pra për të mos i ulur minutat). Atëherë, sa kohë që është e lejueshme edhe nga ligji caktojmë 50 minuta për Partinë Socialiste dhe për Partinë Demokratike dhe nuk ndryshojmë minutat për partitë e tjera. Kështu që sigurohet ajo barazia e merakut tuaj që si koalicioni...

Z. A. Kaziaj: Jo pra se kjo është e interpretueshme nga ligji sipas jush jo e lejueshme nga ligji. Nga ligji është ajo që thamë. Kështu që interpretimi që ju i jepni është pak...

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.13.04.2023*

